



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:273236

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06101357

**Ac.nr.3504/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit A.G. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.Q., avokat nga Prizreni, kundër debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (KEDS), me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, objekt i përmbartimit, kthimi në punë, kompensimi i të ardhurave personale dhe shpenzimeve procedurale, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.2321/2021 të datës 08.04.2022, me datë 29.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.APROVOHET** e themeltë ankesa e debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizimin me Energji Elektrike sh.a. (KEDS), me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.2321/2021 i datës 08.04.2022, në pikën II të dispozitivit në pjesën që ka të bëjë me shpenzimet për përgjigje në prapësim dhe në këtë pjesë gjykohet si në vijim: **DETYROHET** debitorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizimin me Energji Elektrike sh.a. (KEDS), me seli në Prishtinë, që kreditorit A.G. nga Prizreni, në emër të shpenzimeve për përgjigje në prapësim t’ia paguaj shumën prej 312.00 euro.

**II.** Pika I, pika II në pjesën ku është vendosur për shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim, për taksë gjyqësore, për ekspertizë, dhe për përfaqësim në seancë gjyqësore, dhe pika III e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.2321/2021 të datës 08.04.2022, mbeten të pa shqyrtuara.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e atakuar CP.nr.2321/2021 të datës 08.04.2022, në pikën I, të dispozitivit ka përfunduar procedurën e përmbartimit në çështjen juridike të

përmbaramit CP.nr.2321/2021, për shkak të përmbushjes së detyrimit, nga debitorja e përmbaramit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS) me seli në Prishtinë dhe atë sipas dokumentit të përmbaramit - aktgjykimit të formës së prerë i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.2569/2016, i dt.01.11.2019. Në pikën II, ka aprovuar si të bazuar propozimin e av.M.Q. nga Prizreni, për caktimin e shpenzimeve të procedurës së përmbaramit, në këtë çështje juridike përmbaramore, ka caktuar shpenzimet e procedurës së përmbaramit dhe atë: në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbaram në shumën prej 312,00 € ; në emër të shpenzimeve për taksën gjyqësore në shumën prej, prej 100.00 € ; në emër të shpenzimeve për ekspertizë shumën prej 150.00 € ; në emër të shpenzimeve për përgjigjen në prapësim, shumën prej 624,00 € dhe në emër të shpenzimeve për një seancë gjyqësore shumën prej 270.40 € dhe gjithsejtë në shumën e përgjithshme prej 1,456,00 eurove (njëmijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë euro). Në pikën III, ka obliguar debitorin e përmbaramit, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS) me seli në Prishtinë, që kreditorit të përmbaramit, A.G. nga Prizreni, të autorizuarit të tij av.M.Q. nga Prizreni, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës së përmbaramit të cekura në dispozitivin e II. dhe atë në xhirollogarinë bankare me nr... në BKT-Bankë, dhe atë në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të lartësisë së shpenzimeve procedurale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa ashtu që të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të anulohet urdhri për përmbaram për pjesën II të dispozitivit lidhur me shpenzimet e përmbaramit ose të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaramore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori kundër debitorit pranë gjykatës së shkallës së parë me datë 06.12.2021, ka paraqitur propozimin për përmbaram në bazë të dokumentit të përmbaramor aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.2569/2016, të datës 01.11.2019, i plotfuqishëm nga data 10.11.2021, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 25.11.2021, për shkak të kthimit në punë dhe të ardhurave personale. Gjykata, me aktvendimin CP.nr.2321/2021 të datës 07.12.2021, ka lejuar përmbaramin. Kundër aktvendimit për lejimin e përmbaramit, pala debitore, me datë 14.02.2021, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori me datë 20.12.2021, ka ushtruar përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin CP.nr.2321/2021 të datës 21.12.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitores, ndërsa aktvendimin për lejimin e përmbaramit CP.nr.2321/2021 të datës 07.12.2021 e ka lënë në fuqi. Debitori nuk ka ushtruar ankesë kundër aktvendimit CP.nr.2321/2021 të datës 21.12.2021, dhe

ky aktvendim është bërë i përmbarueshëm dhe i formës së prerë në procedurën e përmbarimit. Tuje, gjykata ka vazhduar procedurën përmbarimore ndërsa pas paraqitjes së parashtrës nga i autorizuari i kreditorit, ku e ka njoftuar gjykatën se kreditori është kthyer në vendin e tij të punës, dhe është përmbushë urdhri për ekzekutimin e pagesave të pa paguar, gjykata e shkallës së parë e ka përfunduar përmbarimin ashtu që ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka konstatuar se në këtë çështje juridike të përmbarimit, duhet të përfundohet procedura e përmbarimit për shkak të përmbushjes së kredisë së kreditorit konform nenit 66 par.4 të LPP-së, e pasi që në rastin konkret pala kreditore si në propozimin për përmbarim, ka kërkuar nga pala debitore që kreditorin ta kthejë në vendin e punës, si dhe të ia paguaj të ardhurat personale, mjetet monetare nga marrëdhënia e punës si dhe shpenzimeve të gjykuara të procedurës kontestimore dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, ndërsa me parashtrën e dt.04.04.2022, i autorizuari i kreditorit, e ka njoftuar gjykatën se kreditori është kthyer në vendin e tij të punës, dhe është përmbushë urdhri për ekzekutimin e pagesave të pa paguar, andaj për këtë arsye edhe e ka përfunduar procedurën e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit, për shkak të përmbushjes së kredisë së kreditorit, për kthim në punë dhe detyrim në të holla të palës kreditore. Lidhur me shpenzimet e procedurës së përmbarimit gjykata e shkallës së parë ka vendosur duke u bazuar në nenin 13 par.4 të LPP-së, lidhur me nenin 452 të LPK-së, si dhe në bazë të tarifës së OAK-së, duke konstatuar së pala debitore me veprimet e veta i ka shkaktuar shpenzimet e procedurës së përmbarimit në këtë çështje përmbarimore në shumën e aprovuar, ndërsa pala kreditore i ka kërkuar shpenzimet.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë sa i përket pikës II të dispozitivit të aktvendimit të atakuar në pjesën ku është vendosur për lartësinë e shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim nuk është i drejtë dhe ligjshëm, për çka aktvendimi i atakuar në këtë pjesë është dashur që të ndryshohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përkundër faktit se aktvendimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht tarifa e OAK-së, ku është vendosur lidhur me lartësinë e shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, për çka në këtë pjesë është dashur që të ndryshohet aktvendimi i atakuar. Sipas Rregullores për Tarifën e Avokatëve të datës 18.03.2017, nr. tarifor 6, për përpilimin e parashtrës në procedurën civile dhe procedurat tjera, për përmbarimin në bazë të titullit përmbarimor me vlerë mbi 10.000 euro, e më lartë parashihet baza e shpenzimeve prej 160 euro + klauzul. 50% në vlerë prej 80 euro + paushalli prej 30% në vlerë prej 72 euro, gjithsejtë 312.00 euro. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë edhe përkundër faktit që në mënyrë të drejtë ka vendosur që të detyrohet debitori që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës së përmbarimit, gabimisht ia ka njohur kreditorit shumën prej 624.00 euro, për përpilim të përgjigjes në prapësim pasi që kjo shumë i njihet palës në rastin kur kemi tre kreditorë apo debitor, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me një kreditor dhe një debitor dhe është dashur që t'i njihet shuma prej 312.00 euro. Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore duke vlerësuar pretendimet ankimore me referim në

dispozitën e nenit 208 dhe 209, pika c), lidhur me nenin 201 par. 1, pika d) të LPK-së vendosi që aktvendimin në pjesën e atakuar ta ndryshoj duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që lidhur me pikën I, III dhe pjesërisht pikën II, të dispozitivit të aktvendimit të atakuar në pjesën ku është vendosur për shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim, për taksë gjyqësore, për ekspertizë, dhe për përfaqësim në seancë gjyqësore, nuk ka pasur pretendime ankimore nga pala debitore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika c) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.3504/2022, datë 29.08.2024

Gjyqtari,  
Hysni Bardheci